

## **Bashkëpunimi midis KLSH dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN) vijon me workshop-in e radhës mbi auditimin e Network Security dhe Firewalls**

Në datat 5 - 9 Qershor 2023, në qytetin e Vlorës u zhvillua workshop-i ndërmjet ekspertëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë dhe audituesve të Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (DATI) dhe disa audituesve financiarë të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Ky workshop nisi punimet e tij në vijimësi të trajnimeve të zhvilluara më parë dhe erdhi si rezultat i bashkëpunimit frytdhënës ndërmjet dy institucioneve supreme të auditimit: KLSH-së dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë (OAGN).

Nga SAI i Norvegjisë morën pjesë ekspertët e auditimit të TI: znj. Hanne Nordrehaug (Team Leader), z. Espen Møystad, z. Håvard Hulbak, z. Jonas Horneland dhe z. Ole Høglund (auditues dhe këshilltarë të auditimit të IT).



Objektivi i përgjithshëm dhe aktivitet kryesorë të zhvilluara ishin si vijon:

### **Objektivi**

### **Aktivitetet**

1. Përmirësimi i cilësisë së auditimeve të TI-së në KLSH mbi sigurinë e informacionit dhe qeverisjen e TI-së

- 1.1. Përshkrimi i mjedisit të IT në subjekte, identifikimi dhe prioritizimi i sfidave
- 1.2. Identifikimi i nevojave për trajnime dhe zhvillimi i tyre
- 1.3. Zhvillimi i një auditimi pilot IT të përbashkët
- 1.4. Aktivitete të qëndrueshmërisë

Qëllimi i workshopit të zhvilluar u fokusua në:

- Mbajtjen e një trajnimi praktik mbi sigurinë e rrjetit dhe Firewalls;
- Aftësimin e audituesve IT të KLSH-së në lidhje me temat e trajtuara, teknikat, mjetet dhe procedurat e auditimit në auditimet e tyre të planifikuara;
- Diskutimin mbi vijimësinë dhe planet e mëtejshme për vitin 2023 dhe 2024.

Trajnimet ishin të strukturuar dhe të ndara me nga dy ditë një temë. Temat e trajtuara në trajnim ishin:

- 1) NS01 - Auditimi bazik i Network Security
- 2) NS02 - Auditimi bazik i Network-ve dhe Firewalls (Cisco ACL)

Secila temë u trajtua në formën teori dhe praktikë, ku pas prezantimit të ekspertëve norvegjezë, audituesit patën mundësinë të punojnë në praktikë për shkruajtjen e skripteve dhe ekstraktin e të dhënave, kontrollin e konfigurimeve, etj., në një ambient virtual me “VMware” të ndërtuar nga kolegët norvegjezë.



Në përmbyllje të ditëve të trajnimit u diskutua edhe për hapat që do të ndiqen për zhvillimin e takimit të radhës, i cili mendohet të zhvillohet pranë zyrave të OAGN në Oslo, Norvegji, ndërmjet grupeve të punës. Gjithashtu, mendohet edhe kryerja e një auditimi pilot të përbashkët me ndihmesën dhe mbikëqyrjen e ekspertëve norvegjezë që do të zhvillohet në tremujorin e parë ose të dytë të vitit 2024 në një subjekt auditimi (për t'u përcaktuar në vijimësi).

Pas përfundimit të trajnimit ditën e dytë, audituesit e KLSH shoqëruan audituesit norvegjezë në një tur kulturor dhe historik të qytetit të Vlorës.

Ky workshop u shoqërua me diskutime të frytshme midis audituesve të KLSH dhe atyre të SAI-t norvegjez, të cilat patën si synim shkëmbimin e eksperiencave të fituara në auditimet përkatëse, si dhe u diskutua mbi takimet dhe hapat e mëtejshëm konkretë që do të ndiqen në kuadër të këtij bashkëpunimi.